



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 367/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatëve koalicionit NISMA-AKR-PD, Behxhet Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi-Krasniqi, Valdrin Lluka, Refiçe Tërnavë dhe Sedat Islmajli, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pa lejuar ankesa e kandidatëve, Behxhet Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi-Krasniqi, Valdrin Lluka, Refiçe Tërnavë dhe Sedat Islmajli, nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ),

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 10.10.2019, nga kandidatët, Behxhet Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi-Krasniqi, Valdrin Lluka, Refiçe Tërnavë dhe Sedat Islmajli, nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër KQZ-së, duke pretenduar se votat e fituara në kuadër të koalicionit NISMA-AKR-PD, kanë rezultuar se janë në mos përputhje me rezultatet tona si kandidat të cilat janë paraqitur në formularin e rezultateve të kandidatëve dhe të thënave reale që kanë arritur nga vëzhguesit dhe komisioneret tanë. Më tutje theksojnë se mospërputhja ka ndodhur në numrin më të madh të qendrave të votimit në Malishevë, Prizren, Klinë, Pejë, Ferizaj dhe Drenas, për të cilat kërkojnë rinumërimin e tyre.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë e pretenduara gjatë numërimit të votave dhe mos përputhjen e rezultateve në numrin më të madh të qendrave të votimit në Malishevë, Prizren, Klinë, Pejë, Ferizaj dhe Drenas, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës së Behxhet Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi-Krasniqi, Valdrin Lluka, Refiqe Tërnavë dhe Sedat Islmajli, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 367/2019 më datën 10.10.2019

**Kryesuesi i Panelit
Gyltënë Sylejmani**



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.